



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 18.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 14.08.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **EKOTERMIKA SHPK, Suharekë** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Renovimi dhe instalimi i nxemjeve në AMF dhe QMF”**, me Nr. të Prok: **613-20-3688-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **EKOTERMIKA SHPK, Suharekë** të dt. 14.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Renovimi dhe instalimi i nxemjeve në AMF dhe QMF”**, me nr. të Prok: **613-20-3688-5-2-1**

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë, **TERMO SOIAR ENGINEERING SHPK Suharekë** i datës 14.08.2020 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Mbetet në fuqi** Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 14.08.2020;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, me datë 18.08.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pikat që oferta juaj është eliminuar janë:

Ju si OE ne paramasen tuaj keni gabime aritmetikore qe kaloni vleren 2% nga qmimi i hapjes (formulari i tenderit) qmimi i juaj ne formular te tenderit ka qene 10.333.33 euro, pas llogaritjes se paramases suaj juve ju ngritet qmimi ne 10.544.48 euro, ndryshimi eshte 211.15 euro qe kjo vlere kalon 2% dhe oferta juaj eshte renditur si e eliminuar.

AK ka vepruar sipas LPP dhe nuk ka bere shkelje siq pretendoni ju si OE ankues,

Ky pretendim i juaji është i pabazuar

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Adem Duriqi

Drejtor i Prokurimit

